

PLANIFIKIMI I PROJEKTEVE SHKOLLORE

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij moduli pjesëmarrësit duhet të jenë të aftë:

- ta kuptojnë rolin dhe rëndësinë e definimit dhe të analizës së problemeve si pikënisje për planifikimin e një projekti;
- ta definojnë sistemin e objektivave të një projekti në bazë të transformimit të trungjeve problemore në trungje të objektivave;
- ta kuptojnë strukturën e kornizës logjike dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë në procesin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të projekteve;
- ta drejtojnë procesin e planifikimit të një projekti me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara.

Përmbajtja

Elemente të planifikimit strategjik. Tema simuluese. Diagnostika e problemeve. Grupëzimi i problemeve. Analiza e shkaqeve dhe pasojave. Ndërtimi i trungjeve të suksesit. Analiza e opsioneve të mundshme. Kuptimi i kornizës logjike. Logjia e intervenimit. Treguesit e suksesit. Analiza e rrezikut. Plani operativ i projektit. Buxheti i projektit. Parashtrimi i projektit.

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet të punësuarve në administratën arsimore, mësimdhënësve dhe pjesëtarëve të komunitetit shkollor, si dhe të gjithë atyre që tregojnë interesim për të zotëruar teknikat e planifikimit të projekteve shkollore.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të një seminari 2-ditor dhe ka gjithsej **16 orë**.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja mbi 80% në seminar.